



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 11600 Prot

Gjirokastrë më, 07/10/2026

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 30.04.2026

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës. 30.04.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më 30.04.2026 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet pranë UNED-it. Mbledhja fillon në orën 12:08.

Marrin pjesë në mbledhje 20 anëtarë prezent dhe 1 online (Viron Peta). Mungojnë në mbledhje këshilltarët Rova , Pandos, Kristidhi, Feruni, Shehaj ,Novi ,Leskaj, Mahmutaj , Kondi, Cacaj.

Hapet mbledhja nga Znj.Isaraj.Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj hap mbledhjen dhe lexon rendin e ditës duke njoftuar këshilltarët se ka dhe disa pika që nuk janë shënuar te rendi i ditës që kanë të bëjnë me :

- P/Vendim " Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin prill 2026.
- P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet dhe individët për muajin prill 2026".
- P/Vendim “ Për miratimin e Komisionit të Strehimit për Programet Sociale të Strehimit”
- P/Vendim “ Për shprehjen e pëlqimit për lidhjen e marreveshjes operationale midis Bashkisë Gjirokastrë dhe OJF-së TID Gjirokastra”.
- P/ Vendim “Për një shtesë në vendimin nr. 101, datë 22.12.2025 “ Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” për shpërndarjen e fondeve të trashëguara”.

Z.Petrit Brahimi ndërpret fjalën e k. këshillit dhe shpreh se kemi 4 muaj që nuk po marim në analizë asnjë institucion në varësi të bashkisë,,nuk ka asnjë informacion nga drejtoritë e bashkisë të cilat duhet të vinin dhe të raportonin për ecurinë e tyre sipas planit të miratuar nga vetë ne , cdo muaj duhet të vi një drejtori e të japi llogari këtu duhet të respektohet ligji..

Ne nuk dimë se çfarë është bërë me përmbytjet, do jepet ndonjë ndihmë për familjet e bizneset a qeveria do të japi ndonjë ndihmë , kemi probleme dhe me bujqësinë dhe me komunalen.

Znj. Isaraj : specifikoje se cilat drejtori kërkon dhe të vijnë të raportojnë në mbledhjen e ardhshme se nuk është se është bërë kërkesa dhe ne nuk e kemi futur në rend dite, miratojmë njëherë rendin e ditës pastaj kalojmë te këto problematika.

Znj. Isaraj hedhim në votim miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastrë për rendin e ditës që propozova?

Miratohet me 20 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online futja e pikave së mësipërme në rendin e ditës.

Miratohet rendi i ditës me 21 vota pro.

1. P/Vendim " Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin prill 2026.
2. P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet dhe individët për muajin prill 2026".
3. P/Vendim " Për miratimin e Komisionit të Strehimit për Programet Sociale të Strehimit"
4. P/Vendim " Për shprehjen e pëlqimit për lidhjen e marrëveshjes operacionale midis Bashkisë Gjirokastrë dhe OJF-së TID Gjirokastra".
5. P/ Vendim "Për një shtesë në vendimin nr. 101, datë 22.12.2025 " Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026" për shpërndarjen e fondeve të trashëguara".
6. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.03.2026 ora 12:00 dhe 10.04.2026 ora 12:00.
7. P/Vendim " Për miratimin e raportit të monitorimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2024, Bashkia Gjirokastrë".
8. P/Vendim " Për krijimin e Grupit Mbështetës Zjarrfikës me kontratë të përkohshme për mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në Bashkinë Gjirokastrë.
9. Trajtim i kërkesave të qytetarëve.

- Hidhet në votë dhe miratohen me 20 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 21 vota pro rendi i ditës.
- Znj. Isaraj lexon pikën 1 dhe 2 të rendit të ditës të cilat kanë kaluar dhe janë miratuar në mbledhjen e Komisionit të Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale, Rinisë dhe Barazisë Gjinore. P/Vendim " Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin prill 2026. P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet dhe individët për muajin prill 2026".

Hidhet në votë dhe miratohen me 20 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 21 vota pro.

- Znj. Isaraj, kalohet në votim pika 3 e cila është:

P/Vendim “ Për miratimin e Komisionit të Strehimit për Programet Sociale të Strehimit”

Znj. Isaraj shprehet se kjo pikë ka kaluar dhe është miratuar në mbledhjen e Komisionit të Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale , Rinisë dhe Barazisë Gjimore.

Z. Aliko: Kërkoj informacion se përse në këto komisione nuk janë dhe këshilltarë të opozitës.

Znj. Isaraj: Z. Aliko nuk lejohet që në këto komisione të marrin pjesë këshilltarët pasi ata nuk mund të përfshihen në veprimtari administrative.

Ka dikush tjetër dicka për të shtuar?

Hidhet në votë dhe miratohen me 20 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 21 vota pro pika e sipërcituar.

- Znj. Isaraj: kalohet në votim pika 4 e cila është:

P/Vendim “ Për shprehjen e pëlqimit për lidhjen e marreveshjes operacionale midis Bashkisë Gjirokastër dhe OJF-së TID Gjirokastra”.

Z. Brahim: kërkoj diskutim dhe sqarim për këtë material, avantazhet e kësaj marreveshje cilat janë?

Znj- Llapaj : Shumica prej jush e njohin TID Gjirokastra e cila është një nga ato modelet e bashkëpunimit si me Bashkinë Gjirokastër dhe është një urë lidhëse ndërmjet biznesit dhe operon në zonën e pazarit ku bëjnë pjesë rreth 100 biznese. Përveç aktiviteteve kulturore që organizohen nga ne, ne ofrojmë dhe shumë shërbime të tjera të cilat janë ndricim, pastrim, gjelbërim dekorim etj.Por TID shërben dhe për përthithjen e aktiviteteve të huaja dhe organizimin e tyre si dhe donacione të huaja të cilat shërbejnë për zhvillimin sa me të qëndrueshëm të pazarit.

Për sa i përket funksionimit parashikon zhvillimin e biznesi në këtë zonë , pas miratimit të biznesit është propozuar kjo marreveshje operacionale me bashkinë që ofron një mbështetje prej 2,000,000 lekësh pjesa tjetër do të mbulohet nga bizneset e zonës së pazarit të cilat do të marrin dhe shërbime si çështje shërbimi i transportit të valixheve për turistët e huaj.

Z. Nurce: Në lidhje me artizanët ka ndonjë projekt që mendohet të bëhet për këtë kategori?Pasi po diskutohet mbijetesja e artizanëve të cilët mbartin vlera dhe janë pjesë e historisë së këtij qyteti.

Znj. Llapaj: Kjo gjëja nuk mund të bëhet drejtpërsëdrejti vetëm me lekët që bashkia jep por unë mund të them këtë gjë se po mundohemi dhe shikohet mundësia për organizimin e klasave të punës me financim të donatorëve të huaj ku të bëhet e mundur mësimi i artizanëve të rinj dhe promovimi i këtyre vlerave.

Z. Golemi: Ari deri në vitin 2023 ku kemi patur marreveshjet me TID kemi qënë korrekt me pagesat dhe me aktivitetet e TID në zonën e pazarit. Pas vitit 2023 dhe deri sot nuk ka funksionuar bashkëpunimi me këtë organizatë për shkak të keq administrimit të bërë nga

administrator i mëparshëm pasi e shifnin TID si një drejtori jo paralele. Po flasim për 20 milion të vjetra që kaq mund të shkojë një aktivitet i organizuar nga TID ndërkohë që para vitit 2024 kemi bërë aktivitete me vlerë shumë më të madhe se kaq. Se bashku me ADF parashikojmë që të shkojmë rreth 300.000 euro, pra japim 20 dhe marim 10 fishin në këmbim.

Unë besoj fort që Alesia do ta cojë para këtë projekt, kemi mbështetjen e ADF partner të rëndësishëm dhe sigurisht mbështetje financiare. Nëse do të funksionojë jemi ok, dhe nëse nuk funksionon si 2023, 2024, 25 nuk kemi dhënë asnjë qindarkë sepse kemi parë që nuk ka funksionuar. Dhe me biznesin kemi diskutuar pra bizneset vet do të vendosin se ku do të bëhen këto aktivitete pasi nuk mund të bëhen vetëm në një vend pra do bëhet një shpërndarje

Hidhet në votë dhe miratohen me 20 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 21 vota pro pika e sipërcituar

- Znj. Isaraj, kalohet në votim pika 5 e rendit të ditës e cila është:

P/ Vendim “Për një shtesë në vendimin nr. 101, datë 22.12.2025 “ Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” për shpërndarjen e fondeve të trashëguara”. Dhe ky material ka kaluar në komision. Ka ndonjë pyetje?

Z. Brahimi: Ne nuk jemi specialist, ky material ka kaluar në komision dhe jemi në rregull.

Znj. Koko: Ky material ka të bëjë me fondet e trashëguara të pa përdorura nga buxheti i vitit 2025 dhe një pjesë e këtyre fondeve janë nga procedura të pa përdorura për vitin 2025 dhe për këtë vit i akordohen burimeve të reja.

Z. Brahimi: Arsyet pse nuk janë përdorur këto lekë?

Z. Koko: Një nga arsyet kryesore është se për vitin 2025 ka patur disa kontrata shumë vjecare, janë kontrata që kanë filluar në 2024 dhe vazhdojnë 2025, 2026 apo kanë filluar në 2025 dhe mbyllen në 2027.

Z. Hila: Cilat kanë qënë propozimet e bëra nga Komisioni i Ekonomisë?

Z. Llogo: Nuk kemi bërë asnjë propozim thjesht kemi dëgjuar dhe njohur me materialin dhe ishte cdo gjë e qartë.

Z. Golemi: z. këshilltar më vjen mirë për këtë situatë financiare të bashkisë për të bërë të mundur disa ndërhyrje. Në fondin rreth 30 milion lekë që do të kalojnë Shërbimeve Publike qoftë për materiale ndërtimi qoftë për pajisje e kosha ku emergjente është blerja e një kamioni vetëshkarkues.

Ne kemi një emergjencë në një kanal vaditës në zonën e Cepunës, aty kemi një rëshkitje masive ku dhe ka dëmtuar kanalën vaditës dhe kemi një ndryshim në shumën prej 10 milion lekë që do të hiqet nga materialet e ndërtimit dhe do të kalojë për rehabilitimin e këtij kanali për të bërë të mundur kalimin e ujit për fermerët.

Z. Aliko: Ai kanal mbulon një pjesë të konsiderueshme të fushave por me këtë fond 10 milion lekë po duan që ta bëjnë të qëndrueshme të investohet tamam se aty vaditen 40-50 ha fushë dhe ai kanal është shumë funksional për atë zonë atje.

Z. Golemi: Dasho kjo ndërhyrje është emergjente.

Z. Aliko: Një gjë të kemi parasysh që cdo gjë që bëhet emergjentë nuk bëhet shumë rezistente prandaj ajo ka kohë Akoma më mirë të vendosim 5 lekë më shumë dhe ta bëjmë të saktë.

Z. Golemi: Dasho duhet me patjetër që atë kanal ta bëjmë funksional për këtë sezon pastaj më pas patjetër do ndërhyet për zgjidhje definitive.

Gjithashtu kemi parashikuar një fond rreth 40 milion lekë të vjetra për kryerjen e 2 studimeve gjeologjike pasi si ce dimë kemi dy zona të nxehta njëra është Labova e Zhapës në të cilën kemi bërë një rrugë emergjente dhe për të kaluar te projekti kërkohet studimi gjeologjik si dhe në lagjen Manalat po e njëjta gjë. Ndërhyrja në lagjen Manalat do të bëhet me buxhetin e bashkisë ndërsa ndërhyrja në Labovën e Zhapës do të bëhet me mbështetjen e qeverisë. Ndërsa për Lazaratin do të ndërhyet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike pasi nuk ka rezikshmëri dhe nuk kërkon studim gjeologjik.

Znj. Isaraj: Ka dicka tjetër për të shtuar ?

Hidhet në votë dhe miratohen me 20 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 21 vota pro pika e sipërcituar.

- Znj. Isaraj, kalohet në votim pika 6 e rendit të ditës e cila është:

Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.03.2026 ora 12:00 dhe 10.04.2026 ora 12:00 që bërëm një mbledhje jashtë radhe, e keni marë si matërial, janë përfshirë të gjitha komentet..Ka dicka nga ana e këshilltarëve?

Hidhet në votë dhe miratohen me 20 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 21 vota pro pika e sipërcituar.

- Znj. Isaraj, kalohet në votim pika 7 e rendit të ditës e cila është:

P/Vendim “ Për miratimin e raportit të monitorimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2024, Bashkia Gjirokastrë”.

Edhe ky material ka kaluar në komisionin respektiv.

Hidhet në votë dhe miratohen me 20 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 21 vota pro pika e sipërcituar.

- Znj. Isaraj, kalohet në votim pika 8 e rendit të ditës e cila është:

P/Vendim “ Për krijimin e Grupit Mbështetës Zjarrfikës me kontratë të përkohshme për mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në Bashkinë Gjirokastrë.

Edhe ky material ka kaluar në komision.

Ka ndonjë pyetje?

Z. Hila: Kjo është një procedurë standarte 6 mujorë janë këta, sipas ligjit,

Hidhet në votë dhe miratohen me 19 vota pro nga të pranishmit pasi z. Armand Hilaj u largua dhe 1 online në total 20 vota pro pika e sipërcituar.

Znj. Isaraj :Pika e fundit është trajtimi i kërkesave të qytetarëve, na ka ardur një kërkesë nga kryetarët e 2 fshatrave, Lazarat dhe Kordhoc në lidhje me disa problematika që kanë ngritur në mbledhjen e kryesisë së dy fshatrave, me tu administruar si material e kemi përcjellë te Zv. Kryetarja pasi kanë ngritur në sërë problematikash.

Zv. Kryetarja, Amarilda: një nga pikat e bëra në kërkesë është ndricimi dhe po ju them që jemi në proces për bërjen e ndricimit duke filluar nga Kordhoca deri në fshat. Janë rreth 35 ndricues që do të montohen në të dy fshatrat.

Z. Golemi: janë rreth 35 ndricues që janë investim i Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe janë ndricues me eficencë dhe me garanci. Brenda këtyre dy muajve besoj se do të vendosen si faza e parë e këtij projekti dhe pastaj do vazhdohet me hapat e tjerë sepse është një fshat që realisht ka banorë dhe duhet të investojmë në këtë pjesë.

Për pjesën e infrastrukturës dhe sidomos për rrugët kemi kërkuar te paketa e asfaltimeve që të përfshihet dhe fshati Lazarat, pra ndricim dhe riasfaltimin besoj se do ti mbyllim me FSHZH.

Zv. Kryetarja: Një nga pikat e ankesës është dhe shembja e rrugës të cilën ne e përmendëm që do të bëhet me investim nga bashkia nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ne kemi parashikuar në fillim të vitit një fond dhe me ndryshimet e tanishme drejtorisë përkatëse i krijohet mundësia financiare për të realizuar këto ndërhyrje.

Z. Golemi: Ne me këtë buxhet kemi parashikuar një projekt për reabilitimin e Sopotit me të cilin zgjidhet një pjesë e mirë e këtyre problematikave në këtë fshat.

Znj. Isaraj , nëse nuk gjë tjetër për të shtuar ju falenderoj dhe e mbyllim këtu këtë mbledhje.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Bexhet BAXHELLA

KRYETAR I KËSHILLIT
Merita ISARAJ

